



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1394/8 prot.

Datë 27/10/2022

**V E N D I M**

**Nr. 1052/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27/10/2022shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “REJ” SHPK dhe “VASHTEMIA” SHPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-21749-03-10-2022, me objekt “Loti 7 Mirembajtje me performance e segmentit rrugor K/Podgorie - K/Liqena” me fond limit: 59.075.701 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “REJ” SHPK  
*Adresa: Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
*Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.*

**Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “VASHTEMIA” SHPK  
*Adresa: Rruga Nacionale Korçë - Pogradec, Km i 7 500 m majtas rrugës nacionale, zona kadastrale nr. 3716, nr. pasurie 686/5 686/6, Vashtemi, Libonik, Korçë.*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.03.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-21749-03-10-2022, me objekt “Loti 7 Mirembajtje me performancë e segmentit rrugor K/Podgorie - K/Liqena” me fond limit 59.075.701 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një) leke

pa-TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 08.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 08.06.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi vlerësimin (*faza e dytë*) përfundimtar me pikë të ofertave të paraqitura nga ofertuesit e kualifikuar si vijon:

- |                     |             |
|---------------------|-------------|
| 1. “VASHTEMIA” SHPK | 238,35 pikë |
| 2. “REJ” SHPK       | 225,15 pikë |

II.3. Në datën 20.06.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE. Sipas këtij njoftimi, operatori ekonomik “*Vashtemia*” SHPK është shpallur fitues i kësaj procedure prokurimi.

II.4. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 29.06.2022, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1394 prot, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK dhe po më datë 29.06.2022 është protokolluar ankesa e këtij operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë kundërshtohet vlerësimi me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë “*Rej*” SHPK dhe “*Vashtemia*” SHPK si më poshtë vijon:

*“OE ankimues “REJ” shpk, është njoftuar nëpërmjet mesazhit elektronik me datë 08.06.2022 për vlerësimin me pikë të ofertës së paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi dhe ofertën e paraqitur nga shoqëria “VASHTEMIA” shpk si më poshtë*

*VASHTEMIA 238.35 pikë*  
*REJ 225.15 pikë*

*Duke gjykuar se vlerësimi i kryer nuk është i drejtë e objektiv paraqesim këtë ankesë përse më poshtë vijon.*

*Sqarojmë se fillimisht OE ankimues i është drejtuar me kërkesë Autoritetit Rrugor Shqiptar, me anë të shkresës datë 07.06.2021 duke i kërkuar si më poshtë:*

*“Me datë 08.06.2022 nëpërmjet SPE jemi njoftuar për vlerësimin me pikë dhe renditjen si më poshtë:*

- |              |             |
|--------------|-------------|
| 1. VASHTEMIA | 238.35 pikë |
| 2. REJ       | 225.15 pikë |

*Nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkojmë të informohemi zyrtarisht mbi metodologjinë e ndjekur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi përlogaritjen e pikëve dhe një kopje të procesverbalit përkatës.*

*Informacioni i kërkuar, bazohet pikërisht në zbatim të nenit 81 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilën është parashikuar e drejta e çdo pale të interesuar për të marrë informacion dhe detyrimi i autoritetit kontraktor ti vërë në dispozicion, kërkuarit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit, informacionin e kërkuar. ... ”.*

*Deri në datën e paraqitjes së kësaj ankese, në shkelje të procedurave të prokurimit nuk rezulton të jetë kthyer një përgjigje, duke i mohuar një të drejtë themeltare OE ankimes.*

*Edhe pse nuk jemi njohur për metodologjinë e ndjekur nga KVO pranë autoritetit kontraktor, sërish e kundërshtojmë këtë ankesë përsa më poshtë vijon:*

*Në nenin 41 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik është parashikuar:*

*“Autoriteti ose enti kontraktor në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj.*

*Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:*

*a) procedurë e hapur;*

*b) procedurë e kufizuar;*

*c) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;*

*ç) partneritet për inovacion;*

*d) dialogu konkurrues;*

*dh) procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;*

*e) procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; ë) procedurë e hapur e thjeshtuar;*

*f) shërbim konsulence.”.*

*2. Për prokurimet me vlerë nën kufirin e ulët monetar të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.”.*

*Ndërkohë në nenin 43 të LPP-së është parashikuar:*

*“1. Procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.*

Në rastin e kontratave sektoriale, kur entet kontraktore kanë shpallur një njoftim periodik të informacionit, që është përdorur si mjet për të bërë ftesën për konkurrim, ky afat është jo më pak se 15 ditë.

3. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.

Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

4. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, kur autoritetet kontraktore kanë shpallur një njoftim paraprak të informacionit, që nuk është përdorur si mjet për të bërë ftesën për pjesëmarrje, afati kohor minimal për pranimin e ofertave apo kërkesave për pjesëmarrje, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, bëhet 10 ditë nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) njoftimi paraprak i informacionit përfshin të gjithë informacionin që kërkohet sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, në rast se ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak i informacionit;

b) njoftimi paraprak i informacionit është shpallur nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës së shpalljes të njoftimit të kontratës.

5. Për procedurat e kufizuara ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, afatet kohore minimale të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë:

a) për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, afati kohor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës;

b) për pranimin e ofertave, afati kohor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e ftesës për ofertë. Në procedurat e kufizuara ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afatet kohore minimale të përcaktuara nga enti kontraktor janë:

i. për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, afati kohor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës.

ii. afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është jo më pak se 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

6. Autoriteti kontraktor mund të shkurtojë me 5 ditë afatin kohor për marrjen e ofertave në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike.

Në rast se dokumentet e tenderit nuk janë të disponueshme nëpërmjet mjeteve elektronike, sipas

parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji, afati për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 ditë.”.

Në nenin 45 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik është parashikuar:

“Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.
2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë? kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 t? LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale?.”.

Ndërkohë pikën 4.4 të DST, janë parashikuar kriteret e përzgjedhjes së fituesit e konkretisht:

#### A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- **çmimi** pikët [0 - 50 ]
- **Pervoja ne pune e kompanise** pikët [0 - 30]
- **Cilësia** pikët [0 - 15]
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** pikët [0 – 5 ]

Metodologjia e vlerësimit për ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto.

Nga AK është parshikuar se metodologjia e përzgjedhjes së ofertës më të mirë për secilin kriter vlerësimi si më poshtë:

**Kriteri:**

1. **Çmimi** [50] pikë

**Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.**

**Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:**

$$P_{k1} = V_{min1} \times P_{max1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  **Pikët e kriterit që vlerësohet**

$V_{min1}$  **Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet**

$P_{max1}$  **Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet**

*O<sub>k1</sub> Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet*

*(2) Pervoja ne pune e kompanise [0- 30 pikë]*

*Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.*

*(2)/a. Përvojë e ngjashme, punime për ndertim rrugësh / rikonstruksion rruge [0-10 pikë]*

*(2)/b. Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh [0- 20 pikë]*

*(3) Cilësia [0 – 15 pikë]*

*Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve te rehabilitimit (jo më pak se 2 vjet) dhe çdo aktiviteti tjetër.*

*(4)Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0- 5 pikë]*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.*

*Nën-kriteri:*

*a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.*

*[0 - 3 pikë]*

*b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet sherbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.*

*[0 - 2 pikë]*

*\*Shënim – Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret) duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.*

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**Së pari**, fillimisht, vërehet se veprimi administrativ i KVO dhe autoritetit kontraktor për mosnjohimin e OE ankimes mbi specifikën e ndjekur për pikëzimin për secilin kriter të ofertës sonë bie ndesh dhe me vet parashikimet e AK në DST.

**Së dyti**, duke u nisur nga kriteret e parashikuar në DST në përzgjedhjen e fituesit, ne çojmë se vlerësimi i ofertës së paraqitur prej nesh bie ndesh me kriteret e parashikuara në DST.

**Konkretisht:**

**a)** Lidhur me kriterin “Çmimi” rezulton se shoqëria jonë ka doëzuar një ofertë ekonomike më të leverdishme për autoritetit kontraktor se ajo e shoqërisë VASHTEMIA shpk, e për rrjedhojë shoqëria jonë lidhur me këtë kriter duhet të marrë pikëzimin maksimal, pra 50 pikë.

**b)** Përsa i përket kriterit “Përvoja në punë e kompanisë” mendojmë se vlerësimi i kryer nga KVO është subjektiv dhe i pabazuar, pasi nga ana e OE “REJ” shpk janë dorëzuar dokumentacioni dhe CV e shoqërisë ku në të janë të listuara punë të ngjashme të kryera nga shoqëria “REJ” shpk në plotësim të pikëve maksimale të kriterit të kërkuar e konkretisht:

<b>Kontrata viti 2005, 2006, 2007</b>			
Ndertim Zyra U. Kanalizime Sh.a.	x euro		
Sistemim,kanalizim,ndricim dhe asfaltim Blloku Kala	x leke		
Rikonstruksion,ndricim Spitali Pogradec	x leke		
Ndertim shkolle 8-vjecare Cerrave+Lunik	x leke		
Ndertim i mureve mbajtes ne Varrezatekzistuese Pogradec	x leke		
Rruge e Sistemim i varrezave te reja Guras	x leke		
Ndertim ujesjellesi i fshatit Lin	x leke		
Sistemim, kanalizime UZ, asfaltim Blloku Rinia, qyteti Pogradec	x leke		
Ndertim kanali ujites Hudenisht	x leke		
Rikonstruksion rruga Hotolisht	x leke		
<b>Kontrata viti 2007 - 2008</b>			
Rikonstruksion rruga Hudenisht, Proptisht	x leke		
Rikonstruksion rruge Selce — Homcan	x leke		
Asfaltim rruge Komuna Rrajce	x leke		
Ndertim ujesjellsi Kotodesh, Komuna Rrajce	x leke		
Ndertim KUZ Tushemisht — Bucimas	x leke		
Rikonstruksion objekte social kulturore Arsimore ne komunen Kashar , Tirane	x leke		
Punime per H/TermKosove (Pogradec)	x leke		



<b>Kontrata viti 2008 - 2009</b>			
<i>Pastrimi Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion rruga "Qazim Murtini" Librazhd</i>	<i>x leke</i>		
<i>Sistemim ujra te bardha komuna Cerrave</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2009 - 2011</b>			
<i>Rruga Hocisht 2, Komuna Hocisht</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rruga Shqitas komuna Pirc</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rruge brenda fshatit Podgorije Komuna Vreshtas</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rruga Shyec Komuna Proger</i>	<i>x leke</i>		
<i>Pastrim Lumi Remenjit Komuna Bucimas</i>	<i>x leke</i>		
<i>Sistemim asfaltim Lagjia 7, Bashkia Korce</i>	<i>x leke</i>		
<i>Shkolla Laktesh, Komuna Velcan, Pogradec</i>	<i>x dollare</i>		
<i>Shfrytezim Fe — Ni Cervenaka Juglindore</i>	<i>x leke</i>		
<i>Ndertim shkolle Udenisht</i>	<i>x leke</i>		
<i>Punime rrugore per Euro Teorema</i>	<i>x leke</i>		
<i>Punime HEC per MTC ENERGY</i>	<i>x leke</i>		
<i>Ndertim Qender Shendetsore, Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2012 - 2013</b>			
<i>Rruga Fshati Memelisht, Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Shkolle, Komuna Trebinje</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion shkolle, Komuna Qender Bilisht</i>	<i>x leke</i>		
<i>Ndertim Qender Shendetsore, Komuna Bucimas</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Rruge, Komuna Proptisht</i>	<i>x leke</i>		
<i>Pastrim Udenisht 2012</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Rruga "Xhemal Tafaj", Tirane</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Rruga "28Nentori", Tirane</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2014</b>			
<i>Rikonstruksion Ministria e Mbrojtjes</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Prokuroria e rrethit Pogradec</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Ministria e Drejtesise</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Sheshi Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2015</b>			
<i>Pastrimi i qytetit Pogradec</i>	<i>x leke</i>		
<i>Mbrojtja nga gerryerjet Peqin</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion mige fshati Cervenake</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion cati dhe fasada Maliq</i>	<i>x leke</i>		
<i>Blerje transformatore</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion ministria e Mbrojtjes</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2016</b>			

<i>Nenstacion levizes Himare</i>	<i>x leke</i>
<i>Pajisje per likujdim avarie</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion Rrjeti Kashar Mezez</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion rrjeti shijak</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim Kanali Maliq</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim kanali Delvine</i>	<i>x leke</i>
<i>Rruga shefqet Musaraj Tirane</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2017</b>	
<i>Nenstacion levizes 110/20 kv Fushe-Kruje</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion Fideri Voskopoje, BiIisht,Pojan</i>	<i>x leke</i>
<i>Asfaltim i rrugëve të brendshme të Fshatit Mushqeta</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtje Objekteve DSHS Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 1-Linja TU me percjelles ABC, kabina Vashtemi</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 2-Linja TU me percjelles ABC kabina Lumalas 1, 2</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 3-Linja TU me percjelles ABC Kabina Bulgarec</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 4-Linja TU me percjelles ABC Kabina Maliq</i>	<i>x leke</i>
<i>Portobarazhi kolektori i Sovjanit</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim Ujesjellesi Varove Skroske</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion i Sheshit Qendra Shendetesore+Qendra</i>	<i>x leke</i>
<i>Blerje Cakulli</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion i Ujësjetësimit Velcan - Urak</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim Perroi Zvezde</i>	<i>x leke</i>
<i>Përmirësimi banesa Komunitetin Rom dhe Egjyptian</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2018</b>	
<i>Ndërtim mur mbajtës Rruga Dardhas - Osnat</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim rrugësh blloku Goricë+Shtesa</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtja e Objekteve per Spitalin Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim argjinature</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2019</b>	
<i>Mirembajtje kanali ujites Buzaishte - Laktesh</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim/perforcim banesash ekzistuese</i>	<i>x leke</i>
<i>Per nje shtese fondi Sistemim rruges blloku Gorice</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim/Sistemim i rrugicave tek lagjia Kalaja</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrimi Bashkise Prrenjas (5 vjecar)</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti I: Mirembajtje e objekteve te Spitalit Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Mbrojtje nga lumi Devoll, ura Zemblak dhe Diga Korce</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2020</b>	
<i>Shtese Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec+ Njësive</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim Blloku Nr. 5, (Segmenti Iani BASHO)</i>	<i>x leke</i>

<i>Rikonstruksion i Ures te Rruga e Kabashit, Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec dhe Njësive</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim asfaltim rrugesh blloku i banimit te Rruga e Kabashit</i>	<i>x leke</i>
<i>Permiresim /Rikonstruksion i banesave ekzistuese per familjet e varfera dhe te pafavorizuara ne Bashkine Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim ura Zalli i Torres, njesia administrative Proptisht Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi i pastrimit te Njesive Administrative Qender, Novosele, Shushice te Bashkise Vloreë</i>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi I mirembajtjes per njesie administrative Lekas</i>	<i>x leke</i>
<i>Ujesjellesi i Mokres Faza e I, Bashkia Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Largimi i inerteve te rruges provizore dhe kthimi i bregut te liqenit ne gjendjen e meparshme ne aksin Lin-Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim riparim krahu i djathte i rezervuarit Gjanc</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2021</b>	
<i>Sherbim i Pastrimit te Njesise Administrative Sukth</i>	<i>x leke</i>
<i>Lidhja e Urës Zall Torre me rrjetin rrugor - Ndertimi i Mbeshteteses te mesit</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim i Ujesjellesit Lin</i>	<i>x leke</i>
<i>Ujësjiellësi i Mokrës Faza e II-të , Bashkia Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtja e ambienteve te fizioterapise 509'577.5 lek</i>	<i>x leke</i>
<i>Perfundimi i punimeve te rruga Kabashit</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim i Rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim i ures ne Maliq dhe portave/pritave te saj</i>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi i Pastrimit dhe Grumbullimi i mbetjeve urbane ne Bashkine Lushnje</i>	<i>x leke</i>
<i>Ujësjiellësi,I Fshatit Duhanas,Fshatit Lapardha 1, Otllak Dhe Orizaj, Bashkia Berat”</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 9 : “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbllak — Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec - Plasë ”</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2022 e ne vazhdim</b>	
<i>Sherbimi i Pastrimit dhe Grumbullimi i mbetjeve urbane ne Bashkine Lushnje</i>	<i>x leke</i>
<i>Transporti i mbetjeve urbane nga qyteti i Prrenjasit në Incenerator (Elbasan) pranë Metalurgjikut”</i>	<i>x leke</i>

<i>Loti 2 : “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë</i>	<i>x leke</i>
<i>Shërbim pastrimi Spitalin Universitar të Traumës</i>	<i>x leke</i>
<i>Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë”</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Gjitashtu janë paraqitur dhe punët e ngjashme dhe të listuara si më poshtë</i></b>	
<i>Sistemim Asfaltim I rruges lart fshati Memlisht, Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I Shkolles se mesme Trebinje</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim dhe largim mbeturina nga Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I Rruges Xhemal Tafaj</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I pjesshem I godines dhe nyjeve Sanitarete pergjithshme ne Ministrine e Mbrojtjes</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim Sheshi Qender Udenisht Rruga Nacionale</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim, grumbullim dhe Largim I mbeturinave publike te Qytetit te Pogradecit</i>	<i>x leke</i>
<i>Mbrojtje nga Gerryerjet e Tokes Kanali Peqin-Kavaje</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I cative dhe Fasadave te objekteve ne migen kryesore, qyteti Maliq</i>	<i>x leke</i>
<i>Blerje transformatore</i>	<i>x leke</i>
<i>Nenstacion levizes Himare</i>	<i>x leke</i>
<i>Pajisje per likujdim avarie</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 1-Linja TU me percjelles ABC, kabina Vashtemi</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 2-Linja TU me percjelles ABC kabina Luma1as1,2</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 3-Linja TU me percjelles ABC Kabina Bulgarec</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 4-Linja TU me percjelles ABC Kabina Maliq</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion Fideri Voskopoje, Bilisht,Pojan</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtje Objekteve DSHS Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim Rrugesh Blloku Gorice</i>	<i>x leke</i>
<i>Per nje shtese fondi te Objekti Sistemim Rrugesh Blloku Gorice</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim/perforcimbanesash ekzistuese</i>	<i>x leke</i>
<i>Mbrojtje nga Lumi Devoll Ura zemblak dhe Diga</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim I linjes se ujesjellesit nga burimi I ujit ne Galerine 1070 deri ne depo uji Varove Skroske</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim Riparim KU krahu I djathte I rezervuarit Gjanc</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec</i>	<i>x leke</i>

<i>Sistemim asfaltim rrugesh blloku i banimit te rruga e Kabashit</i>	<i>x leke</i>
<i>Shtese Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec+ Njësi</i>	<i>x leke</i>
<i>Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec dhe Njësi</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtja e ambienteve te fizioterapise</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 9 : “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmb1a—kPlasë</i>	<i>x leke</i>
<i>Asfaltim I rrugeve te brendshme te fshatit Mushqeta</i>	<i>x leke</i>

*Si dhe gjithashtu është paraqitur dhe metodologjia, plani i organizimit të punës dhe plani i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe shëndetit në punë.*

*Duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria jonë ka qënë dhe më parë pjesmarrëse në procedura prokurimi së bashku me shoqërinë VASHTEMIJA dhe ankimeve të kryera nga palët ka dijeni mbi kapacitet teknike përsa i përket eksperiencës së ngjashme, por dhe eksperiencën në treg dhe njohurive mbi kapacitetet teknike të operatorëve të ndryshëm të cilët operojnë në treg, në rafshin krahasimor, shoqëria REJ shpk, referuar objektit të prokurimit në veprimtarinë e saj shfaq një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit dhe sistemimit të rrugëve. Me dokumentacionin e paraqitur dëshmojmë se kemi realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit dhe me vlera të konsiderueshme e si rrjedhojë pretendimi ynë për një vlerësim sa më afër kufirit maksimal lidhur me komponentin eksperiencë e ngjashme është tërësisht i bazuar.*

*Procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” është plotësuar më së miri nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Vlerësimi i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastin konkret nuk është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” shpk pasi vlera e kontratave të ngjashme të realizura është tepër e lartë e cila meriton një pikëzim sa më afër maksimales.*

*Gjithashtu, fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (eksperienca e ngjashme dhe cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur*

*pretendime. Në kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar edhe një garanci nga ana e operatorit ekonomik për sa i përket cilësisë së punimeve që duhet të jetë brenda një periudhe 24 mujore. Për këtë fakt operatori ekonomik “Rej” shpk ka paraqitur një garanci për një periudhë më të gjatë se ajo e kërkuar nga autoriteti dhe konkretisht 2 vite e 5 muaj e shprehur kjo tek cilësia e punimeve.*

*Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyçe të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë.*

*Ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.*

*Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj.*

*Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Rej” shpk, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ana tjetër, në mënyrë kryesisht të cuditshme nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me shumë më pak pikë se kufiri maksimal i vendosur në DT. Metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik përbëhet nga 6 seksione:*

- *HYRJE*
- *QËLLIMI DHE KUSHTET E PUNËS*
- *MENAXHIMI I EMERGJENCAVE, SIGURIMI TEKNIK NE PUNE DHE MBROJTJA E MJEDISIT*
- *METODOLOGJIA E PUNIMEVE(MIREMBAJTJE RUTINE-PUNIME REHABILITIMI)*
- *KUSHTET TEKNIKE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE*
- *PLANI I MENAXHIMIT TE SIGURISE DHE SHENDETIT NE PUNE,*
- *METODOLOGJITE E PUNIMEVE*

*Nga seksionet e mësipërme, tre nga të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës në drejtim të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes nga*

*mjedisi, metodologjinë e punimeve të mirëmbajtjes, kushtet teknike të zbatimit të punimeve dhe planimit të menaxhimit të sigurië dhe shëndetit në punë.*

*Jemi të bindur se në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, nga OE VASHTEMIA është paraqitur një metodologji e përgjithshme në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” shpk i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës.*

*Në nivel krahasimor, dallueshëm nga ana e operatorit ekonomik “REJ” shpk është paraqitur një metodologji e detajuar, me kantiere mbështetëse dhe kantier kryesor të propozuar për t’u ngritur duke patur të barazlanguar secilën pikë nga 15 km, në ndryshim nga ajo e paraqitur nga OE Vashtemia shpk etj.*

*Në tërësi në nivel krahasimor, materiali i paraqitur nga OE REJ shpk është paraqitur në material më i detajuar se ofertuesi tjetër i vlerësuar me pikë maksimale.*

*Së fundmi, përsa i përket kriterit lidhur me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social nga ana e shoqërisë REJ shpk është paraqitur materiali përkatës ku në nivel krahasimor është tërësisht më i plotë dhe i detajuar se ajo i ofertuesit tjetër VASHTEMIA shpk dhe për rrjedhojë duhet të ndryshojë dhe përllogaritja e pikëve të vlerësimit ku oferta e shoqërisë REJ shpk duhet të vlerësohet me pikët maksimale dhe ajo e shoqërisë VASHTEMIA shpk me pikë minimale.*

*Konkretisht nga analizimi i materialit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Rej” shpk, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor për vlerësimin maksimal. Nga ana tjetër, në mënyrë krejtesisht të çuditshme nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me shumë më pak pikë se kufiri maksimal i vendosur në DT*

*Plani I propozuar nga ana e operatorit ekonomik përbëhet nga 7 seksione:*

- **TË PËRGJITHSHME**
- **KUADRI LIGJOR**
- **PËSHKRIMI I PROJEKTIT**
- **PËSHKRIMI I SHKURTËR I SEGMENTIT RRUGOR**
- **IDENTIFIKIMI I DISA KARAKTERISTIKAVE TË ZONËS SË PROJEKTIT**
- **PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT**
- **IDENTIFIKIMI I IMPAKTEVE NEGATIVE DHE MASAT ZBUTËSE**
- **TRAJNIMET DHE RAPORTIMET**

*Nga seksionet e mësipërme, 4 nga të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të dhe mbrojtjes së mjedisit, Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin), Përdorimi i makinerive, pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan të detajuar të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. Propozime konkrete për përmirësim të ekonomisë lokale të zonës.*

*Jemi të bindur se në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, nga OE VASHTEMIJA është paraqitur një metodologji e përgjithshme në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik "REJ" shpk i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës.*

*Në tërësi në nivel krahasimor, materiali i paraqitur nga OE REJ shpk është paraqitur në material më i deatajuar se ofertuesi tjetër i vlerësuar me pikë maksimale.*

*Përsa më sipër, çmujmë se vlerësimi i kryer nga ana e KVO është tërësisht jo objektiv dhe për rrjedhojë kërkojmë rivlerësimin e pikëve, duke aplikuar në çdo rast përsa më sipër pretenduar një vlerësim maksimal për ofertën e paraqitur nga OE "REJ" SHPK dhe një vlerësim më të ulët për ofertën e paraqitur nga shoqëria "VASHTEMIJA" SHPK."*

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1394/3, date 30.06.2022 lidhur me kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë "REJ" SHPK dhe "VASHTEMIJA" SHPK.

II.7. Sa më sipër, lidhur me shqyrtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, më datë 01.07.2022 operatori ekonomik ankimes ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumenta shtesë dhe sqarues lidhur me ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:

*Shoqëria "REJ" SHPK ka paraqitur një ankim administrativ si pranë Autoritetit Kontraktor por dhe Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me procedurën e prokurimit me objekt "Loti 7 "Mirembajtje me performance e segmentit rrugor K/Podgorie - K/Liqena.*

*Në thelb të ankesës së tij, ankuesi, ka pretenduar për një vlerësim jo objektiv të ofertës së paraqitur prej tij lidhur me pikëzimin dhe për pikëzimin maksimal të ofertës së shoqërisë "VASHTEMIJA" SHPK.*

*Fillimisht shoqëria "REJ" SHPK i është drejtuar me kërkesë autoritetit Rrugor Shqiptar, me anë të shkresës datë 07.06.2021 duke i kërkuar:*

*Me datë 08.06.2022 nëpërmjet SPE jemi njoftuar për vlerësimin me pikë dhe renditjen si më poshtë.*



Nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkohet të informohemi zyrtarisht mbi metodologjinë e ndjekur nga anëtarët e komisionit të vlerësiinit të ofertave mbi përlllogarifjen e pikëve dhe një kopje të procesverbalit përkatës.

Informacioni i kërkuar, bazohet pikërisht në zbatim të nenit 81 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilën është parashikuar e drejta e çdo pale të interesuar për të marrë informacion dhe detyrimi autoritetit kontraktor të vërë në dispozicion, kërkuesit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit, informacionin e kërkuar.

Neni 81

*E drejta për informim*

Informacioni dhe dokumentacioni i administruar sipas nenit 99 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave.

Autoritetit ose enti kontraktor është i detyruar të vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit.

a) çdo kandidat të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në tender,-

b) çdo kandidat, i cili nuk është renditur për në fazën e dytë, kur autoriteti ose enti kontraktor ka përdorur uljen e numrit të kandidatëve,

c) çdo ofertues të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të ofertës së tij,

ç) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për klasifikimin e ofertës së përzgjedhur.

3. Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet ose entet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose çënon interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë. Nëse disa pjesë të ofertës së operatorëve ekonomikë deklarohen si konfidenciale, atëherë këto dokumente nuk do të vihen në dispozicion të kërkuesve.

Ka rezultuar, se pas dorëzimit të ankesës si në AK dhe në KPP, nëpërmjet shërbimit postar jemi njohur me shkresën e AK nr. 6739/I prot, datë 20.06.2022 me lëndë “Vënie në Dispozicion”

Nëpërmjet kësaj shprese, AK, informon ankuesin mbi pikëzimin për secilin kriter për ofertat e pataqitura nga shoqëria “REJ” SHPK dhe “VASHEMIA” SHPK si më poshtë:

1. Pikët për Operatorin Ekonomik “REJ” SHPK të shprehura në pikë sipas formulës.

Anëtari i KVO-se	Oferta ekonomike	Pikët për çmimin	Përvoja në punë e Kompanisë	Cilësia	Pikët për uljen në ndikimin e mjedisit dhe social	Total
1	46.624.935	50	11	11	3	75
2	46.624.935	50	11	11	3	75
3	46.624.935	50	11	1.1	3	75

**2. Pikët për operatorin ekonomik "VASHTEMI" SHPK të shprehura në pikë sipas formulës.**

Anëtari i KVO-se	Oferta ekonomike	Pikët për çmimin	Përvoja në punë e Kompanisë	Cilësia	Pikët për uljen në ndikimin e mjedisit dhe social	Total
1	49.030.010,4	47.5	19	10	3	79.5
2	49.030.010,4	47.5	19	10	3	79.5
3	49.030.010,4	47.5	19	10	3	79.5

Siç vërehet, lidhur me kriterin e vlerësimit të ofertës shoqëria jonë është vlerësuar me pikët maksimale (50 pikë ndërsa oferta e paraqitur nga shoqëria VASHTEMI shpk është vlerësuar me 47.5 pikë.

Për kriterin përvoja e kompanisë shoqëria "REJ" SHPK është vlerësuar me 11 pikë ndërsa oferta e paraqitur nga "VASHTEMI" SHPK është vlerësuar me 17 pikë

Kjo diferencë pikëzimi vjen si rrjedhojë e një vlerësimi jo objektiv:

a) Përsa i përket krterit Përvoja në punë e kompanisë, mendojmë se vlerësimi i kryer nga KVO është subjektiv dhe i pabazuar, pasi nga ana e OE "REJ" SHPK janë dorëzuar dokumentacioni dhe CV e shoqërisë ku në të janë të listuara punë të ngjashme të kryera nga shoqëria "REJ" SHPK në plotësim të pikëve maksimale të kriterit të kërkuar e konkretisht:

<b>Kontrata viti 2005, 2006, 2007</b>	
Ndertim Zyra U. Kanalizime Sh.a.	x euro
Sistemim,kanalizim,ndricim dhe asfaltim Blloku Kala	x leke
Rikonstruksion,ndricim Spitali Pogradec	x leke
Ndertim shkollë 8-vjecare Cerrave+Lunik	x leke
Ndertim i mureve mbajtes ne Varrezatekzistuese Pogradec	x leke

<i>Rruge e Sistemim i varrezave te reja Guras</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim ujesjellesi i fshatit Lin</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim, kanalizime UZ, asfaltim Blloku Rinia, qyteti Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim kanali ujites Hudenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion rruga Hotolisht</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Kontrata viti 2007 - 2008</i></b>	
<i>Rikonstruksion rruga Hudenisht, Proptisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion rruge Selce — Homcan</i>	<i>x leke</i>
<i>Asfaltim rruge Komuna Rrajce</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim ujesjellsi Kotodesh, Komuna Rrajce</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim KUZ Tushemisht — Bucimas</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion objekte social kulturore Arsimore ne komunen Kashar , Tirane</i>	<i>x leke</i>
<i>Punime per H/TermKosove (Pogradec)</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Kontrata viti 2008 - 2009</i></b>	
<i>Pastrimi Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion rruga “Qazim Murtini” Librazhd</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim ujra te bardha komuna Cerrave</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Kontrata viti 2009 - 2011</i></b>	
<i>Rruga Hocisht 2, Komuna Hocisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rruga Shqitas komuna Pirc</i>	<i>x leke</i>
<i>Rruge brenda fshatit Podgorije Komuna Vreshtas</i>	<i>x leke</i>
<i>Rruga Shyec Komuna Proger</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim Lumi Remenjtit Komuna Bucimas</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim asfaltim Lagjia 7, Bashkia Korce</i>	<i>x leke</i>
<i>Shkolla Laktesh, Komuna Velcan, Pogradec</i>	<i>x dollare</i>
<i>Shfrytezim Fe — Ni Cervenaka Juglindore</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim shkollë Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Punime rrugore per Euro Teorema</i>	<i>x leke</i>
<i>Punime HEC per MTC ENERGY</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim Qender Shendetsore, Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Kontrata viti 2012 - 2013</i></b>	
<i>Rruga Fshati Memelisht, Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion Shkollë, Komuna Trebinje</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion shkollë, Komuna Qender Bilisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim Qender Shendetsore, Komuna Bucimas</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion Rruge, Komuna Proptisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim Udenisht 2012</i>	<i>x leke</i>

<i>Rikonstruksion Rruga "Xhemal Tafaj", Tirane</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Rruga "28Nentori", Tirane</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2014</b>			
<i>Rikonstruksion Ministria e Mbrojtjes</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Prokuroria e rrethit Pogradec</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Ministria e Drejtesise</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Sheshi Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2015</b>			
<i>Pastrimi i qytetit Pogradec</i>	<i>x leke</i>		
<i>Mbrojtja nga gerryerjet Peqin</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion mige fshati Cervenake</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion cati dhe fasada Maliq</i>	<i>x leke</i>		
<i>Blerje transformatore</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion ministria e Mbrojtjes</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2016</b>			
<i>Nenstacion levizes Himare</i>	<i>x leke</i>		
<i>Pajisje per likujdim avarie</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Rrjeti Kashar Mezez</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion rrjeti shijak</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rehabilitim Kanali Maliq</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rehabilitim kanali Delvine</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rruga shefqet Musaraj Tirane</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2017</b>			
<i>Nenstacion levizes 110/20 kv Fushe-Kruje</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion Fideri Voskopoje, Bllisht, Pojan</i>	<i>x leke</i>		
<i>Asfaltim i rrugëve të brendshme të Fshatit Mushqeta</i>	<i>x leke</i>		
<i>Mirembajtje Objekteve DSHS Pogradec</i>	<i>x leke</i>		
<i>Loti 1-Linja TU me percjelles ABC, kabina Vashtemi</i>	<i>x leke</i>		
<i>Loti 2-Linja TU me percjelles ABC kabina Lumalas 1, 2</i>	<i>x leke</i>		
<i>Loti 3-Linja TU me percjelles ABC Kabina Bulgarec</i>	<i>x leke</i>		
<i>Loti 4-Linja TU me percjelles ABC Kabina Maliq</i>	<i>x leke</i>		
<i>Portobarazhi kolektori i Sovjanit</i>	<i>x leke</i>		
<i>Ndertim Ujesjellesi Varove Skroske</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion i Sheshit Qendra Shendetesore+Qendra</i>	<i>x leke</i>		
<i>Blerje Cakulli</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rikonstruksion i Ujësjetësimit Velcan - Urak</i>	<i>x leke</i>		
<i>Rehabilitim Perroi Zvezde</i>	<i>x leke</i>		
<i>Përmirësimi banesa Komunitetin Rom dhe Egyptian</i>	<i>x leke</i>		
<b>Kontrata viti 2018</b>			

<i>Ndërtim mur mbajtës Rruga Dardhas - Osnat</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim rrugësh blloku Goricë+Shtesa</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtja e Objekteve per Spitalin Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim argjinate</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2019</b>	
<i>Mirembajtje kanali ujites Buzaishte - Laktesh</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim/perforcim banesash ekzistuese</i>	<i>x leke</i>
<i>Per nje shtese fondi Sistemim rruges blloku Gorice</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim/Sistemim i rrugicave tek lagjia Kalaja</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrimi Bashkise Prrenjas (5 vjecar)</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti I: Mirembajtje e objekteve te Spitalit Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Mbrojtje nga lumi Devoll, ura Zemblak dhe Diga Korce</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2020</b>	
<i>Shtese Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec+ Njësive</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim Blloku Nr. 5, (Segmenti Iani BASHO)</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion i Ures te Rruga e Kabashit, Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec dhe Njësive</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim asfaltim rrugesh blloku i banimit te Rruga e Kabashit</i>	<i>x leke</i>
<i>Permiresim /Rikonstruksion i banesave ekzistuese per familjet e varfera dhe te pafavorizuara ne Bashkine Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndërtim ura Zalli i Torres, njesia administrative Proptisht Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi i pastrimit te Njesive Administrative Qender, Novosele, Shushice te Bashkise Vloreit</i>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi I mirembajtjes per njesie administrative Lekas</i>	<i>x leke</i>
<i>Ujesjellesi i Mokres Faza e I, Bashkia Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Largimi i inerteve te rruges provizore dhe kthimi i bregut te liqenit ne gjendjen e meparshme ne aksin Lin-Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim riparim krahu i djathte i rezervuarit Gjanc</i>	<i>x leke</i>
<b>Kontrata viti 2021</b>	
<i>Sherbim i Pastrimit te Njesise Administrative Sukth</i>	<i>x leke</i>
<i>Lidhja e Urës Zall Torre me rrjetin rrugor - Ndërtimi i Mbeshteteses te mesit</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim i Ujesjellesit Lin</i>	<i>x leke</i>
<i>UjËsjellËsi i MokrËs Faza e II-tË , Bashkia Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtja e ambienteve te fizioterapise 509'577.5 lek</i>	<i>x leke</i>

<i>Perfundimi i punimeve te rruga Kabashit</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim i Rrugës sË Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim i ures ne Maliq dhe portave/pritave te saj</i>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi i Pastrimit dhe Grumbullimi i mbetjeve urbane ne Bashkine Lushnje</i>	<i>x leke</i>
<i>Ujësjiellësi, I Fshatit Duhanas, Fshatit Lapardha I, Otlak Dhe Orizaj, Bashkia Berat”</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 9 : “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbllak — Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec - Plasë ”</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Kontrata viti 2022 e ne vazhdim</i></b>	<i>x leke</i>
<i>Sherbimi i Pastrimit dhe Grumbullimi i mbetjeve urbane ne Bashkine Lushnje</i>	<i>x leke</i>
<i>Transporti i mbetjeve urbane nga qyteti i Prrenjasit në Incenerator (Elbasan) pranë Metalurgjikut”</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 2 : “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë</i>	<i>x leke</i>
<i>Shërbim pastrimi Spitalin Universitar të Traumës</i>	<i>x leke</i>
<i>Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë”</i>	<i>x leke</i>
<b><i>Gjitashtu janë paraqitur dhe punët e ngjashme dhe të listuara si më poshtë</i></b>	
<i>Sistemim Asfaltim I rruges lart fshati Memlisht, Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I Shkolles se mesme Trebinje</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim dhe largim mbeturina nga Komuna Udenisht</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I Rrugës Xhemal Tafaj</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I pjesshem I godines dhe nyjeve Sanitarete pergjithshme ne Ministrine e Mbrojtjes</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim Sheshi Qender Udenisht Rruga Nacionale</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim, grumbullim dhe Largim I mbeturinave publike te Qytetit te Pogradecit</i>	<i>x leke</i>
<i>Mbrojtje nga Gerryerjet e Tokes Kanali Peqin-Kavaje</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion I cative dhe Fasadave te objekteve ne migen kryesore, qyteti Maliq</i>	<i>x leke</i>
<i>Blerje transformatore</i>	<i>x leke</i>
<i>Nenstacion levizes Himare</i>	<i>x leke</i>
<i>Pajisje per likujdim avarie</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti I-Linja TU me percjelles ABC, kabina Vashtemi</i>	<i>x leke</i>

<i>Loti 2-Linja TU me percjelles ABC kabina Luma1as1,2</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 3-Linja TU me percjelles ABC Kabina Bulgarec</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 4-Linja TU me percjelles ABC Kabina Maliq</i>	<i>x leke</i>
<i>Rikonstruksion Fideri Voskopoje, Bilisht,Pojan</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtje Objekteve DSHS Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim Rrugesh Blloku Gorice</i>	<i>x leke</i>
<i>Per nje shtese fondi te Objekti Sistemim Rrugesh Blloku Gorice</i>	<i>x leke</i>
<i>Rehabilitim/perforcimbanesash ekzistuese</i>	<i>x leke</i>
<i>Mbrojtje nga Lumi Devoll Ura zemblak dhe Diga</i>	<i>x leke</i>
<i>Ndertim I linjes se ujesjellesit nga burimi I ujit ne Galerine 1070 deri ne depo uji Varove Skroske</i>	<i>x leke</i>
<i>Pastrim Riparim KU krahu I djathte I rezervuarit Gjanc</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec</i>	<i>x leke</i>
<i>Sistemim asfaltim rruges blloku i banimit te rruga e Kabashit</i>	<i>x leke</i>
<i>Shtese Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec+ Njësive</i>	<i>x leke</i>
<i>Shërbimit të Pastrimit qytetit Pogradec dhe Njësive</i>	<i>x leke</i>
<i>Mirembajtja e ambienteve te fizioterapise</i>	<i>x leke</i>
<i>Loti 9 : “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmb1a—kPlasë</i>	<i>x leke</i>
<i>Asfaltim I rrugeve te brendshme te fshatit Mushqeta</i>	<i>x leke</i>

*Si dhe gjithashtu është paraqitur dhe metodologjia, plani i organizimit të punës dhe plani i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe shëndetit në punë.*

*Duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria jonë ka qënë dhe më parë pjesmarrëse në procedura prokurimi së bashku me shoqërinë “VASHTEMLIA” SHPK dhe ankimeve të kryera nga palët ka dijeni mbi kapacitet teknike përsa i përket eksperiencës së ngjashme, por dhe eksperiencën në treg dhe njohurive mbi kapacitetet teknike të operatorëve të ndryshëm të cilët operojnë në treg, në rafshin krahasimor, shoqëria “REJ” SHPK, referuar objektit të prokurimit në veprimtarinë e saj shfaq një eksperience të konsiderueshme në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit dhe sistemimit të rrugëve. Me dokumentacionin e paraqitur dëshmojmë se kemi realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit dhe me vlera të konsiderueshme e si rrjedhojë pretendimi ynë për një vlerësim sa më aiër kufirit maksimal lidhur me komponentin eksperiencë e ngjashme është tërësisht i bazuar.*

*Procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kritereve të percaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret*

*dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” është plotësuar më së miri nga operatori ekonomik “Rej|” shpk. Vlerësimi i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastin konkret nuk është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” shpk pasi vlera e kontratave të ngjashme të realizura është tepër e lartë e cila meriton një pikëzim sa më afër maksimales.*

*Gjithashtu, fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (eksperiencia e ngjashme dhe cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime.*

*Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyçe të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë.*

*Ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.*

*Lidhur me kriterin e pikëzimit Cilësia, shoqëria “REJ” SHPK është vlerësuar me 11 pikë, ndërsa oferta e paraqitur nga shoqëria “VASHTEMIA” SHPK është vlerësuar me 10 pikë. Pikëzimi maksimal me këtë kriter është 15 pikë dhe nuk keni asnjë argumentim ligjor apo teknik se pse oferta jonë nuk është vlerësuar maksimalisht. Në materialin e dorëzuar nga ana e shoqërisë sonë përse kemi parashtruar në ankesë, kemi trajtuar në mënyrë të detajuar çdo nënkategori të kërkuar nga autoritetit kontraktor e për më tepër periudha e garancisë së punimeve është më e madhe se ajo e kërkuar nga AK.*

*Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Rej” shpk, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ana tjetër, në mënyrë kryesisht të çuditshme nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me shumë*



më pak pikë se kufiri maksimal i vendosur në DT. Metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik përbëhet nga 6 seksione:

- *HYRJE*
- *QËLLIMI DHE KUSHTET E PUNËS*
- *MENAXHIMI I EMERGJENCAVE, SIGURIMI TEKNIK NE PUNE DHE MBROJTJA E MJEDISIT*
- *METODOLOGJIA E PUNIMEVE(MIREMBAJTJE RUTINE-PUNIME REHABILITIMI)*
- *KUSHTET TEKNIKE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE*
- *PLANI I MENAXHIMIT TE SIGURISE DHE SHENDETIT NE PUNE,*
- *METODOLOGJITE E PUNIMEVE*

*Nga seksionet e mësipërme, tre nga të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës në drejtim të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes nga mjedisi, metodologjinë e punimeve të mirëmbajtjes, kushtet teknike të zbatimit të punimeve dhe planimit të menaxhimit të sigurië dhe shëndetit në punë.*

*Jemi të bindur se në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, nga OE VASHTEMIJA është paraqitur një metodologji e përgjithshme në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” shpk i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës dhe vlerësimi me 10 pikë (1 pikë më pak se ajo oferta e shoqërisë REJ shpk) është tërësisht i pabazuar.*

*Në nivel krahasimor, dallueshëm nga ana e operatorit ekonomik “REJ” shpk është paraqitur një metodologji e detajuar, me kantiere mbështetëse dhe kantier kryesor të propozuar për t'u ngritur duke patur të barazlanguar secilën pikë nga 15 km, në ndryshim nga ajo e paraqitur nga OE Vashtemia shpk etj, çka do të thotë se vlerësimi me 10 pikë i ofertës së shoqërisë VASHTEMIJA shpk në një kohë që material i paraqitur prej tyre në nivel krahasimor është dukshëm më i vakët nuk mundet kurrësesi të vlerësohet me vetëm 1 pikë se oferta e paraqitur nga OE REJ shpk, i cili ka paraqitur në nivel krahasimor një material shumë herë më të plotë dhe të detajuar..*

*Lidhur me kriterin e vlerësimit me pikë, Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social të dyja ofertat janë vlerësuar me nga 3 pikë në mënyrë të padrejtë.*

*Në nivel krasihimor, dallueshëm nga ana operatorit ekonomik “REJ” shpk është paraqitur një metodologji e detajuar, me kantiere mbështetëse dhe kantier kryesor të propozuar për tu ngritur duke patur të barazlanguar secilën pikë nga 15 km, në ndryshim nga ajo e paraqitur nga OE “VASHTEMIJA”SHPKt, çka do të thotë se vlerësimi me 10 pikë i ofertës së shoqërisë “VASHTEMIJA”SHPK në një kohë që material i paraqitur prej tyre në nivel krahasimor është dukshëm më i vakët, nuk mundet kurrësesi të vlerësohet me vetëm 1 pikë se oferta e paraqitur nga OE “REJ” SHPK, i cili ka paraqitur në nivel krahasimor një material shumë herë më të plotë dhe të detajuar.*

*Së fundmi, përse i përket kriterit lidhur me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social nga ana e shoqërisë REJ shpk është paraqitur materiali përkatës ku në nivel krahasimor është tërësisht më i plotë dhe i detajuar se ajo i ofertuesit tjetër “VASHTEMI”SHPK dhe për rrjedhojë duhet të ndryshojë dhe përllogaritja e pikëve të vlerësimit ku oferta e shoqërisë “REJ” SHPK duhet të vlerësohet me pikët maksimale dhe ajo e shoqërisë “VASHTEMI”SHPK me pikë minimale.*

*Konkretisht nga analizimi i materialit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “REJ” SHPK rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor për vlerësimin maksimal. Nga ana tjetër, në mënyrë krejtësisht të cuditshme nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me shumë më pak pikë se kufiri maksimal i vendosur në DT*

*Plani I propozuar nga ana e operatorit ekonomik përbëhet nga 7 seksione:*

- *TË PËRGJITHSHME*
- *KUADRI LIGJOR*
- *PËSHKRIMI I PROJEKTIT*
- *PËSHKRIMI I SHKURTËR I SEGMENTIT RRUGOR*
- *IDENTIFIKIMI I DISA KARAKTERISTIKAVE TË ZONËS SË PROJEKTIT*
- *PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT*
- *IDENTIFIKIMI I IMPAKTEVE NEGATIVE DHE MASAT ZBUTËSE*
- *TRAJNIMET DHE RAPORTIMET*

*Nga seksionet e mësipërme, 4 nga të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të dhe mbrojtjes së mjedisit, Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin), Përdorimi i makinerive, pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan të detajuar të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones*

*Jemi të bindur se në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, nga OE “VASHTEMI”SHPK është paraqitur një metodologji e përgjithshme në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës.*

*Në tërësi në nivel krahasimor, materiali i paraqitur nga OE “REJ” SHPK është paraqitur në material më i detajuar se ofertuesi tjetër i vlerësuar me pikë maksimale.*

*Përse më sipër, çmujmë se vlerësimi i kryer nga ana e KVO është tërësisht jo objektiv dhe për rrjedhojë kërkojmë rivlerësimin e pikëve duke aplikuar në cdo rast përse më sipër pretenduar një vlerësim maksimal për ofertën e paraqitur nga OE “REJ” SHPK dhe një vlerësim më të ulët për ofertën e paraqitur nga shoqëria “VASHTEMI” SHPK.”.*

II.8. Me shkresën nr. 3259/44 prot, datë 05,07,2022 me objekt: “Vënie në dijeni mbi vendimin e shqyrtimit të ankesës” protokolluar me tonën nr. 1394/5 prot, datë 12.07.2022 është dërguar për dijeni pranë Komisionit të Prokurimit Publik përgjigjja e autoritetit kontraktor drejtuar shoqërisë “REJ” SHPK, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur prej tij për procedurën e mësipërme të prokurimit, si më poshtë vijon:

“... Në lidhje me pretendimet tuaja argumentojmë çdo kriter të vlerësimit si më poshtë:

**Kriteri:**

**1. Çmimi [50] pikë**

Përsa i përket vlerësimit me pikë për ofertën ekonomike të paraqitur nga OE “REJ” SHPK, nga verifikimet e kryera rezulton, se në zbatim të formulës së përcaktuar në DST, OE ankimes është vlerësuar me 50 pikë, pikët maksimale. Ndërsa OE “VASHTEMI” SHPK, në zbatim të formulës është vlerësuar me 47.5 pikë.

**Për sa më sipër, pretendimi juaj nuk qëndron.**

**Në pikën 4.4 të DST- ve “Kriteret e vlerësimit”**

**2. Përvoja në punë e kompanisë [0-30 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punët e realizuar në formë CV, shoqëruar me vërtetim punimesh, të kryera në 10 vitet e fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Lidhur me këtë kriter sqarojmë se OE “REJ” SHPK, në eksperiencën e kompanisë ka paraqitur objekte të realizuara gjatë 10 viteve të fundit, të cilat nuk i ka shoqëruar të gjitha me vërtetim punimesh. Ato punime të cilat janë të shoqëruara me vërtetimin përkatës të ngarkuar në SPE janë 27 (njëzet e shtatë) punime të ngjashme për ndërtim rrugësh/rikonstruksion rruge dhe mirëmbajtje rruge.

Nga 27 (njëzet e shtatë) punime janë marrë në konsideratë si objekte që plotësojnë kriterin e punimeve të kërkuara në DST vetëm 9 (nëntë) objekte: 7 (shtatë) për punime ndërtimi/rikonstruksion rruge dhe 2 (dy) mirëmbajtje rrugësh.

Objektet e tjera të ngarkuara në SPE, nuk merren në konsideratë si punë të ngjashme, lidhur me objektin e kontratës në fjalë.

Më poshtë tabela për këto objekte nga OE “REJ” SHPK.

	<b>PUNET E NGJASHME</b>	<b>REJ</b>

<b><i>Përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh/rikonstruksion rruge [0-10]</i></b>		
<b><i>NR</i></b>	<b><i>OBJEKTI</i></b>	<b><i>VLERA</i></b>
<i>1</i>	<i>Siste-Asfaltim rruges fshati Memelisht</i>	<b><i>33,399,912</i></b>
<i>2</i>	<i>Rikonstr i rruges Xhemal Tafaj</i>	<b><i>13,275,864</i></b>
<i>3</i>	<i>Sistem i rruges + shesheve Udenisht</i>	<b><i>29,971,682</i></b>
<i>4</i>	<i>Sistemim asfaltim, blloku Gorice</i>	<b><i>68,194,694</i></b>
<i>5</i>	<i>Shtese blloku Gorice</i>	<b><i>13,144,368</i></b>
<i>6</i>	<i>Mbrojtje lumore nga lumi Devoll, ura Zemblak...</i>	<b><i>50,051,100</i></b>
<i>7</i>	<i>Sist asfaltim blloku tek rruga Kabashit</i>	<b><i>23,509,450</i></b>
	<b><i>TOTALI</i></b>	<b><i>231,547,070</i></b>
<b><i>Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh [0-20]</i></b>		
<i>1</i>	<i>Mirembnajtje me performance K/Zemblak - Dog Gorice, Libonik - Re mbec -Plase</i>	<b><i>28300353</i></b>
<i>2</i>	<i>Mirembnajtje me performance K/Zemblak - Dog Gorice, Libonik - Rembec -Plase</i>	<b><i>44611890.3</i></b>
	<b><i>TOTALI</i></b>	<b><i>72,912,243</i></b>

*Përsa i përket këtij kriteri, OE "VASHTEMLA" SHPK, ka ngarkuar në SPE 48 (dyzet e tetë) punime të ngjashme për ndërtim rrugësh/rikonstruksion rruge dhe mirëmbajtje rruge të shoqëruara të gjitha me vërtetime punimesh. Nga 48 (dyzet e tetë) punime janë marrë në konsideratë si objekte që plotësojnë kriterin e punimeve të kërkuara në DST vetëm 37 (tridhjetë e shtatë) objekte: 28 (njëzet e tetë) për punime ndërtimi/rikonstruksion rruge dhe 9 (nëntë) mirëmbajtje rrugësh.*

*Objektet e tjera të ngarkuara në SPE, nuk merren në konsideratë si objekte të ngjashme, lidhur me objektin e kontratës në fjalë.*

*Më poshtë tabela për këto objekte për OE "VASHTEMLA" SHPK:*

Përsa i përket, vlerës së objekteve të ngjashme të realizuara, krasahimisht paraqiten për të dy OE, sipas tabelës së mëposhtëme:

**TABELE KRAHASUESE**

	<u>Operatori</u>	<b>PUNIME NE RRUGE (LEKE ME TVSH)</b>	<b>MIREMBAJTJE RRUGE (LEKE ME TVSH)</b>
1	REJ SHPK	231,547,070.09	72,912,243
2	VASHTEMLIA SHPK	381,010,363.36	140,011,809.47

Nga krahasimi rezulton se vlera e punimeve të OE REJ SHPK në përqindje kundrejt OE VASHTEMLIA SHPK rezulton në 60.77 % ( $231,547,070.09/381,010,363.36 = 60.77\%$ ), për punimet e ndërtimeve/rikonstruksion rrugësh.

Po kështu, krahasimisht për punimet e mirëmbajtjes OE “REJ” SHPK kundrejt OE “VASHTEMLIA” SHPK rezulton me 52% ( $72,912,243/140,011,809.47 = 52\%$ ).

Nisur nga ky arsyetim, lidhur me kriterin e përvojës së ngjashme në punë, duke marrë në konsideratë eksperiencat e kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve të realizuara nga operatorët ekonomikë, të cilat prevalojnë si kontrata prioritare lidhur me objektin e prokurimit, KSHA vendos se vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i drejtë dhe në përputhje të plotë me kriteret e vlerësimit të përcaktuara shprehimisht në DST.

Përsa më sipër, pretendimi juaj nuk qëndron

### **3. Cilësia {0 -15 pikë}**

Treguesit dhe analiza cilësore në punë, duke përcaktuar elementet e saj si për shembull, por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit (jo më pak se 2 vjet) dhe çdo aktiviteti tjetër.

Referuar kriterit të cilësisë, arsyetohet si më poshtë vijon:

1. Nëse OE “REJ” SHPK gjendjen aktuale të segmentit, për të cilin është hartuar metodologjia e paraqet në mënyrë të përgjithshme, OE “VASHTEMLIA” SHPK ka bërë përshkrim të detajuar për segmente pjesore dhe nevojat që ka për ndërhyrje çdo segment, duke bërë ndarjen si më poshtë:

- a. Hyrja nga Autostrada në Karburanti Kastrati - Fshati Kapote (Kopole) me gjatësi 4.2 km
- b. Fshati Kapote (Kopole) - hyrje Fshati Podgorie me gjatësi 1.4 km

c. Fshati Podgorie - Fshati Bregas (Korrite) me gjatësi 4.8 km

d. Fshati Bregas (Korrite) - Fshati Zvezde deri në përfundim të segmentit (me gjatësi 9.2

2. Segmenti rrugor Podgorie - Liqenas është segment, i cili karakterizohet nga një dimër i ashpër me reshje dëbore ku mirëmbajtjes dimërore duhet t'i jepet prioritet që në organizimin e dislokimit të borëpastrueseve, mjeteve tjera dhe stafit, si dhe depozitave të kripës.

OE "REJ" SHPK në metodologjinë e ngarkuar në SPE, organizimin e mirëmbajtjes dimërore, e pasqyron me: *Mirëmbajtja Dimërore:*

*"Do të kryejmë alokim të borëpastrueses në Zvezde.*

*Kjo shpërndarje është bërë për të patur një efektivitet dhe një barazlargësi të zonave që do mbulohen duke patur parasysh që një borëpastruese i takon afërisht 15 km rrugë për pastrim."*

*Ndërkohë që OE "VASHTEMIJA" SHPK përshkruan si më poshtë:*

*Mirëmbajtja Dimërore: Do të kryejmë alokim të borëpastrueseve në 2 pika.*

*- 1 me vendndodhje në Burimas (Gollobërdë) pranë kantierit të nyjes së inerteve të shoqërisë "Milenium"*

*- 1 me vendndodhje pranë sheshit të karburantit "KASTRATI" në hyrje të aksit.*

*Kjo shpërndarje është bërë për të patur një efektivitet dhe një barazlargësi të zonave që do mbulohen, duke patur parasysh që një borëpastruese i takon 15 km rrugë për pastrim. Por duke qënë që është segmenti ku ka disa zona të banuara dhe qarkullimi është i shpeshtë është menduar nga stafi teknik i shoqërisë që për të patur një efikasitet dhe performancë sa më të mirë dhe përgjigje në kohë në rast emergjence të vendosim në gadishmëri i 2 borëpastrueseve në aksin që do të kryhet shërbimi. Duke qënë se subjekti ynë i ka në pronësi të vetë 3 mjete borëpastruese, mjeti i 3 do të jetë në gadishmëri gjatë gjithë kohës, i cili ndodhet në kantierin e subjektit jo shumë larg aksit.*

3. Përsa i përket Mirëmbajtjes Rutinë:

*OE "REJ" SHPK përveç përshkrimit të përgjithshëm të pasqyruar në DST, nuk jep ndonjë program të veçantë për organizimin e punimeve rutinë, ndërsa OE "VASHTEMIJA" SHPK cilëson:*

*Mirëmbajtja rutinë: Do të ngrihen 3 kantierë të vegjël:*

*1 në fshatin Zvezde prane fushës së sportit, si dhe 2 kantierë të tjerë kryesisht në fshatin Bregas (Korritë) dhe fshati Kapotë (Kopole), ndërsa kantieri kryesor do të jetë pranë kantierit të shoqërisë Milenium shpk, ku dhe do alokohet një borëpastruese, i cili pozicionohet fiks pranë këtij segmenti pranë fshatit Gollobërdë.*

4. Në instalimin e sinjalistikës në rrugë, të përshkruar në metodologji, OE “REJ” SHPK në faqen 99 të metodologjisë cilëson; “Njihni këto shënja si më poshtë. Përdorini ato siç duhet”, ndërkohë që shenjat e paraqitura janë shenja me shënime jo në gjuhën shqipe (por në gjuhën angleze) ndërkohë që Kodi Rrugor Shqiptar, Rregullorja në Zbatim të tij dhe Manuali i Sinjalizimit Shqiptar i kanë të qarta skemat dhe tabelat që duhen përdorur.

Duke qënë se, metodologjia që kërkohet për objekte të tilla duhet të konkretizohet lidhur me segmentin objekt të procedurës dhe jo të ngarkohet më fjalë të përgjithshme, për kriterin e Cilësisë, KSHA vendos se vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i drejtë dhe në përputhje të plotë me kriteret e vlerësimit të përcaktuara shprehimisht në DST.

Përsa më sipër, pretendimi juaj nuk qëndron.

5. Përsa i përket kriterit lidhur me “Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social”, KSHA përveç të tjerave argumenton se është shumë e rëndësishme trajtimi që është bërë nga OE pjëmarrës në këtë procedurë për ndikimin social.

- OE “REJ” SHPK ka paraqitur “Planin e Menaxhimit Social dhe Mjedisor” të konkretizuar, duke identifikuar impaktet pozitive të projektit, si dhe impaktet negative.

Konkretisht:

Identifikimi i impakteve pozitive të projektit

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

Ndikimet positive do të jenë pas punimeve të rehabilitimit dhe gjatë mirëmbajtjes. Ky ndikim do të konsistojë në përmirësimin e rrugeve, në zvogëlimin e numrit të aksidenteve për shkak të disa riparimeve apo vendosjes së sinjalistikës rrugore, ku tani shohim mungesën e tyre.

Përmirësimi i gjendjes dhe sigurisë së rrjetit rrugor në dobi të përdoruesve të tij është një nga objektivat e projektit dhe një nga ndikimet kryesore pozitive.

- Punësim i banorëve në zonat e projektit

Ky projekt do të kontribuojë në punësimin e njerëzve rreth zonës së objektit. Kështu, kompania ka rekrutuar punonjës nga rajoni i Korqës, Pogradecit, Maliqit, etj.

- OE “VASHTEMIA” SHPK me raport specifik ka ngarkuar në SPE “Metodologji, Propozim për uljen e ndikimit social dhe mjedisor”, në të cilin citohet:

Gjatë fazës fillestare për punimet rehabilituese do kemi edhe ndikime indirekte të përkohshme sociale që lidhen drejtpërdrejt me punimet periodike që ky lot përmban për aksin.

- *Punësim i përkohshëm për komunitetin, i cili do të marrë pjesë drejtpërdrejtë në proceset e ndërtimit, gjë e cila do të sjellë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare (hapja e vendeve të punës)*
- *Rritje të ardhurash për shërbimet shitesë që do të duhet të bëhen për punonjësit që do të merren me ndërtimin e këtij projekti.*
- *Rritje e standartit të shërbimeve për komunitetin.*
- *Punësimin e banorëve të zonës për mirëmbajtjen rutinë, gjë e cila do sjellë kontribut të dyfishtë për këta banorë e të ardhurat familjare dhe mirëmbajtje e rrugës nga vetë banorët e zonës.*

*Për sa i përket kësaj pike, KSHA vendos se vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i drejtë dhe në përputhje të plotë me kriteret e vlerësimit të përcaktuara shprehimisht në DST.*

*Përsa më sipër, pretendimi juaj nuk qëndron.*

*Pë sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës*

*Vendosi:*

*I. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 7 “Mirëmbajtje me performancë e segmentit rrugor K/Podgorie - K/Liqena”, me fond limit 59.075.701 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një) lekë pa TVSH, me REF-21749-03-10-2022.*

II.9. Komisioni gjatë shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit dhe argumenteve të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor konstatoi se krahas informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 3258/44 prot, datë 05.07.2022, për një shqyrtim sa më të plotë të pretendimeve të ankimuesit i kërkoi autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1394/6 prot, datë 15.07.2022 “Kërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “REJ” SHPK” që t’i vihen në dispozicion nga ana e autoritetit kontraktor një informacion i hollësishëm mbi procesin e vlerësimit të ofertave lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “REJ” SHPK.

II.10. Me shkresën nr. 7648/1 prot, datë 19.07.2022 protokolluar me tonën me nr. 1394/7 prot, datë 19.07.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i kërkuar me shkresën nr. 1394/6 prot, datë 15.07.2022.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “REJ” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të kriterit të vlerësimit lidhur me çmimin e ofertës të paraqitur prej tij dhe prej shoqërisë “VASHTEMLIA” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 43 pika 3 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se:

*“3. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t’u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.*

*Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.*

*Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t’u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.”.*

III.1.2. Në nenin 45, pika 1, 2, 7 dhe 8, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

*2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose të kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim–cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve, që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

*7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.”.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4, “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: (Per fazen e dyte te procedures)”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

#### **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

##### **A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- **çmimi** pikët [0 - 50]
- **Pervoja ne pune e kompanise** pikët [0 - 30]
- **Cilësia** pikët [0 - 15]
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** pikët [0 – 5 ]

##### **Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto**

###### **Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1,) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b ,3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

###### **Kriteri:**

##### **2. Çmimi**

**[50] pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{kl} = V_{minkl} \times P_{maxkl} / O_{kl}$$

- $P_{kl}$       Pikët e kriterit që vlerësohet
- $V_{minkl}$     Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
- $P_{maxkl}$     Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
- $O_{kl}$       Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

##### **(2) Pervoja ne pune e kompanise**

**[0- 30 pikë]**

Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë se operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor midis tyre. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik “REJ” SHPK në veprimtarinë e tij shfaq një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit dhe sistemimit të rrugëve. Me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik dëshmon se ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit dhe me vlera të konsiderueshme e si rrjedhojë pretendimi i tij për një rivlerësim sa më afër kufirit maksimal lidhur me komponentin përvojës në punë është i bazuar. Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit në procedurat e kufizuara duhet të bëhet në përputhje me metodologjinë e përdorur nga ana e autoriteti kontraktor dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të percaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” është plotësuar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Vlerësimi i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastin konkret nuk është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Ndërkohë sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik “REJ” SHPK për rishikim të pikëve të operatorit ekonomik “VASHTEMIA” SHPK lidhur me komponentin e eksperiencës së ngjashme lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve KPP gjykon se ky operator ekonomik shfaq një eksperiencë shumë të gjatë e të thelluar në fushën e mirëmbajtjes së rrugëve e rrjedhimisht vlerësimi me 14 pikë i këtij operatori është tërësisht i drejtë e i justifikuar me dokumentacionin e paraqitur nga ky i fundit. KPP gjykon se operatorit ekonomik “VASHTEMIA” SHPK shfaq një avantazh më tepër në funksion të plotësimit sa më mirë të komponentit eksperiencë e ngjashme lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve, pasi provon se ka realizuar kontrata jo vetëm të një natyre të ngjashme me objektin, por edhe të njëjtë në një sasi të konsiderueshme. Përsa me sipër, autoriteti kontraktor duhet që të rivlerësojë pikët për ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “REJ” SHPK dhe “VASHTEMIA” SHPK lidhur me kriterin e vlerësimit të përvojës në punë të kompanive, duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar prej tyre, si dhe metodologjisë së zgjedhur për vlerësimin me pikë të ofertave.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “REJ” shpk qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK për një vlerësim maksimal përse i përket kriterit të vlerësimit të lidhur më cilësinë, si dhe për një vlerësim maksimal përse i përket kriterit të vlerësimit lidhur me propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.3.1. Në nenin 43 pika 3 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se:

*“3. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t’u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.*

*Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.*

*Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t’u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.”.*

III.3.2. Në nenin 45, pika 1, 2, 7 dhe 8, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

*2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose të kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim–cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve, që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

*7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

*Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.”.*

III.3.3. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4, “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: (Per fazen e dyte te procedures)”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

#### 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

##### A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- **çmimi** pikët [0 - 50]
- **Pervoja ne pune e kompanise** pikët [0 - 30]
- **Cilësia** pikët [0 - 15]
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** pikët [0 - 5]

##### Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

###### Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehur në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1,) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b ,3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

###### Kriteri:

###### 6. Çmimi

[50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{kl} = V_{minkl} \times P_{maxkl} / O_{kl}$$

$P_{kl}$	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{minkl}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{maxkl}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
$O_{kl}$	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

###### (2) Pervoja ne pune e kompanise

[0- 30 pikë]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

###### (2)/a. Përvojë e ngjashme, punime për ndertim rrugësh / rikonstruksion rruge [0-10 pikë]

###### (2)/b. Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh

[0- 20 pikë]

###### (3) Cilësia

[0 – 15 pikë]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve te rehabilitimit (jo më pak se 2 vjet) dhe çdo aktiviteti tjetër.

**(4) Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social**

**[0- 5 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

**Nën-kriteri:**

- a. **Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efëcente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.**

**[0 - 3 pikë]**

- b. **Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.**

**[0 - 2 pikë]**

**\*Shënim – Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret) duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.**

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**OSE**

**B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □**

**Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).**

III.3.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe kritereve të vlerësimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi për përcaktimin e ofertës ekonomike më të favorshme i nënshtrohet vlerësimit të 4 (katër) kritereve të vlerësimit, të cilat janë çmimi i ofertës ekonomike, përvoja në punë e ofertuesit, cilësia e punimeve të propozuar dhe propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social.

Lidhur me kriterin e vlerësimit cilësia e punimeve të propozuar, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kriter vlerësimi ka përcaktuar peshën e këtij kriteri me intervalin 0-15 pikë, ku për vlerësimin me pikë bazuar në këtë kriter operatorët ekonomikë ofertues duhet të propozojnë treguesit dhe analiza cilësore në punë, duke përcaktuar elementet e saj si për shembull, por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit

të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit (jo më pak se 2 vjet) dhe çdo aktiviteti tjetër.

Ndërsa lidhur me kriterin e vlerësimit propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kriter vlerësimi ka përcaktuar peshën e këtij kriteri me intervalin 0-5 pikë, ku për vlerësimin me pikë bazua në këtë kriter operatorët ekonomikë ofertues duhet të duhet të paraqesin një metodologji të qartë për *minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës* si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS), por vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet i ndarë në 2 (dy) nën-kritere, ku nën-kriteri i parë është *propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike*, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-3 pikë, ndërsa nën-kriteri i dytë është *propozimi konkret për përmirësimet e ekonomisë lokale të zones*, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-2 pikë.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 21, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” që të përzgjedhë në përputhje me nenin 87 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: çmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi (mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 87 të ligjit për prokurimin publik, ku inter allia shprehet se oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kritere të tilla mund të përfshijnë cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij.

Gjithashtu, edhe në nenin 45 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.825, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, është përcaktuar se: “*Në kontratat, që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet, në:*

a) *cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose*



*b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose*

*c) shërbimin, koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.”.*

Sa më sipër, në respekt të nenit 87 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 45 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë kritere vlerësimi të përcaktimit të ofertës fituese, si edhe t’u japë peshë specifike me një sistem të posacëm pikëzimi. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, faktin se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme ku vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriteret e vlerësimit të kërkuara (*cilësia dhe propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social*) dhe së dyti në rrafshin krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së punimeve, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu *cilësia e punimeve dhe propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social*, për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur ta peshojë me 15 pikë cilësinë e punimeve, ndërsa me 5 pikë *propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social*. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

III.3.6. Në lidhje me kriterin e vlerësimit për sa i përket cilësisë, në dokumentet e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë, duke përcaktuar elementet e saj si për shembull, por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket *metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancisë së punimeve të rehabilitimit (jo më pak se 2 vjet) dhe çdo aktiviteti tjetër*, ndërsa për sa

i përket kriterit të vlerësimit lidhur me *propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social* autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kriter vlerësimi ka përcaktuar peshën e këtij kriteri me intervalin 0-5 pikë, ku për vlerësimin me pikë bazuar në këtë kriter operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës, si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS), por vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet i ndarë në 2 (dy) nën-kritere, ku nën-kriteri i parë është propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike, *përdorimi i makinerive/ pajisjeve ekologjike dhe hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore*, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-3 pikë, ndërsa nën-kriteri i dytë është *propozimi konkret për përmirësimet e ekonomisë lokale të zones*, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-2 pikë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në përcaktimin e pikëve për kriteret e sipërpërmendura fillimisht ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentat konkretë që pasqyrojnë elementët e sipërpërmendur për secilin kriter vlerësimi dhe më pas në rrafshin krahasimor, duke përcaktuar se kush ka dhënë propozimet më të mira do të përcaktojë pikët për secilin ofertues përse i përket këtyre kriterëve.

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me riprodhimin e termave të referencës së kryerje së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, riorganizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomikë më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “REJ” shpk, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor për secilin nga kriteret e vlerësimit. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstaton se nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me 11 nga 15 pikë maksimale të metodologjisë së propozuar nga ofertuesi “REJ” SHPK përse i përket kriterit kualifikues të lidhur me *cilësinë e punimeve*, si dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me 2 pikë nga 3 pikë maksimale të metodologjisë së propozuar nga ofertuesi “REJ” SHPK përse i përket nën-kriterit kualifikues të *propozimit konkret për përdorimin e materialeve ekologjike, përdorimi i makinerive/ pajisjeve ekologjike dhe hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore*, si dhe mbi arsyen e vlerësimit me 1 pikë nga 2 pikë maksimale të metodologjisë së propozuar nga ofertuesi “REJ” SHPK përse i përket nën-kriterit kualifikues të *propozimi konkrete për përmirësimet e ekonomisë lokale të zones*.

Metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik “REJ” SHPK përbëhet nga 6 seksione, si më poshtë:

- 1. HYRJE

a) Qellimi i Punës

b) Përshkrim i Shkurter

- c) *Personeli*
- d) *Makineri dhe Pajisje*
- e) *Plani I Organizimit te Kantierit*
- f) *Lista e dokumentave që do te pergatiten gjate zbatimit te kontrates*
- g) *Përshkrimi i Punimeve Periodike/Rehabilitimit që do ofrohen*
- h) *Cilësia e materialeve që do të përdoren*
- i) *Plani për Sigurimin e Cilësisë*

## **2. QELLIMI DHE KUSHTET E PUNES**

- a) *Qellimi i punimeve*
  - b) *Kushtet e perfundimit te punes*
- ### **3. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE, SIGURIMI TEKNIK NE PUNE DHE MBROJTJA E MJEDISIT**

- a) *Te pergjitshme*
- b) *Spitali me i afert*
- c) *Menaxhimi i Aksidenteve dhe Ndhma e Shpejte*
- d) *Vleresimi i riskut*
- e) *Mbrojtja e mjedisit*

## **4. METODOLOGJIA E PUNIMEVE(MIREMBAJTJE RUTINE-PUNIME REHABILITIMI)**

- ❖ *Menaxhimi ambiental*
- ❖ *Punimet me dhera*
- ❖ *Germimi i strukturave dhe mbushja*
- ❖ *Nenbaza granulare*
- ❖ *Shtresa e pare dhe veshja me bitum*
- ❖ *Veshja siperfaqesore*
- ❖ *Kanalet e betonit per drenazhet dhe drenazhet e nendherave*
- ❖ *Pastrimi dhe forma e drenazhimeve ekzistuese*
- ❖ *Barriera me shufra çeliku*
- ❖ *Shenjat e trafikut*
- ❖ *Vijezimi rrugor*
- ❖ *Betonimet per struktura &perdorime te tjera*
- ❖ *Punimet me llaç per strukturat*
- ❖ *Tombinot e tubat e parafabrikuara ne beton*
- ❖ *Siperfaqja e urave*
- ❖ *Mirembajtja dhe Riparimi i Rrugeve me Zhavorr*
- ❖ *Mirembajtja dimerore*
- ❖ *Skemat e sinjalistikes se perkoheshme per menaxhimin e trafikut ne rastet e punimeve ne rruge*

## **5 KUSHTET TEKNIKE TE ZBATIMIT TE PUNIMEVE**

## **6 PLANI I MENAXHIMIT TE SIGURISE DHE SHENDETIT NE PUNE, METODOLOGJITE E PUNIMEVE.**

Ndërsa metodologjitë e propozuara nga operatori ekonomik “VASHTEMLIA” SHPK përbëhen nga këto seksione si më poshtë:

## METODOLOGJIA E PUNES PER REHABILITIMIN DHE MIREMBAJTJEN E RRUGEVE

### 1. PUNIMET PREGATITORE

1.1 Studim i gjendjes fillestare

1.2 Projekti i zbatimit

1.3 Punime Ndertimore, Rilevimi Topografik

### 2. PASTRIMI I RRUGES DHE PUNIMET GERMIM/MBUSHJE

2.1 Punimet e Kullimit

### 3. PUNIMET E SHTRESAVE RRUGORE

3.1 Kompaktesimi dhe pregatitja e tokes per Punimet e Shtresave Rrugore

3.2 Shtresat me gur te copetuar

3.3 Ndertimi i paketes se shtresave rrugore

### 4. NDERTIMI

### 5. DERGIMI, RUAJTJA DHE TRAJTIMI

### 6. PUNIMET NDERTIMORE

6.1 Kanalet prej betonit

6.2 Tombinot

6.3 Muret

6.4 Mbrojtjet e Skarpates

### 7. BARRIERAT E SIGURISE

### 8. SHENJAT E TRAFIKUT DHE SINALISTIKA

## METODOLOGJIA DHE PLANI I ORGANIZIMIT TË SHËRBIMEVE/PUNIMEVE E PËRGJITHSHME

## MOBILIZIMI DHE METODOLOGJIA E REALIZIMIT TE PROCESAVE TE PUNES

Permbajtja:

### 1. HYRJE

1.1. OBJEKTI DHE QELLIMI

### 2. PERSHKRIMI I DETAJUAR I METODOLOGJISE SE PUNES

1.1. METODOLOGJIA E NDERTIMIT

2.2.1. MAKINERITE

2.2.2. PUNETORIA

2.2.3. MBROJTJA E SHENDETIT DHE SIGURISE NE PUNE

2.2.4. PUNIMET PREGATITORE

2.2.4.1. TOPOGRAFIA

2.2.5. NGRITJA E KANTIERIT

2.2.6. PUNIMET E DHERAVE

2.2.7. Veprat e artit

2.2.7.1. Punimet e konstruksionit

- 2.2.7.1.1. Strukturat Beton- Arme
- 2.2.8. KUB dhe KUZ
- 2.2.8.1. Germimi
- 2.2.8.2. Shtrimi dhe mbulimi i tubacionit
- 2.2.8.3. Mbulimi
- 2.2.8.4. Tubacionet
- 2.2.8.5. Depozitimi
- 2.2.8.6. Pusetat
- 2.2.9. Rrjeti elektrik dhe i elektrotelefonise
- 2.2.9.1. Germimi
- 2.2.9.2. Shtrimi dhe mbulimi i tubacionit
- 2.2.9.3. Mbulimi
- 2.2.9.4. Tubacionet
- 2.2.9.5. Depozitimi
- 2.2.9.6. Pusetat
- 2.2.9.7. Shtyllat dhe Ndriculesit
- 2.2.10. Shtresat e rrugeve dhe shesheve
- 2.2.10.1. Shtresat me material inert
- 2.2.10.2. Shtresat asfaltike
- 2.2.10.2.5. Testimi dhe kontrolli i cilesise
- 2.2.10.3. Sinjalistika

## PROPOZIMI PER ULJEN E NDIKIMIT SOCIAL DHE MJEDISOR

### Tabela permbledhese

1. Hyrje
2. Kuadri ligjor
3. Plani i menaxhimit të mjedisit
4. Detyrat dhe Përgjegjësitë e personelit
- 4.1 Menaxher i Mjedist dhe çështjet sociale
- 4.2 Drejtues kantieri
5. Metodologjia e minimizimit të impakteve mjedisore dhe sociale
- 5.1 Reduktimi i ndikimit në ajër
- 5.2 Reduktimi i ndikimit në ujë
- 5.3 Minimizimi i ndikimit në tokë
- 5.4 Minimizimi i ndikimit nga zhurmat dhe vibrimet
- 5.5 Gjenerimi i mbetjeve
- 5.6 Biodiversity, Ecological management
- 5.7 Shfrytëzimi i burimeve natyrore
- 5.8 Ndikimi në mjedisin social
- 5.9 Zonat e mbrojtura
6. Plani i masave zbutese
7. Programi i monitorimit

- 8. Trajnimi dhe raportimi
- 8.1 Trajnimi
- 8.2 Raportimi mbi përputhshmërinë me planet mjedisore dhe sociale
- 9. Mekanizmi i Zgjidhjes se Ankesave
- 9.1. Qëllimi i Procedures
- 9.2. Objektivat
- 9.3. Tipet e Ankesave
- 9.4. Ngritja e Ankeses

## METODOLOGJIA PER PUNIMET E MIREMBAJTJES RRUGORE ME BAZE PERFORMANCE

Hyrje

Qëllimi

Objektivat

1. Konceptet themelore te Kontratave te Mirembajtjes te Bazuara ne Performance....5
2. Pershkrimi i sherbimeve qe do te ofrohen
  - 2.1. Qëllimi i sherbimeve qe do ofrohen
  - 2.2. Pershkrimi i zones ku ndodhet rruga
  - 2.3. Organizimi i kantiereve
  - 2.4. Kriteret e projektimit/skicimeve për Punimet periodike/rehabilitimit
  - 2.5. Lista e dokumentave që do perpilohen nga shoqeria VASHTEMIJA sh.p.k
  - 2.6. Përshkrimi i Punimeve Periodike/Rehabilitimit
  - 2.7. Cilësia e materialeve që do të përdoren
  - 2.8. Stafit teknik ne dispozicion te kesaj kontrate
  - 2.9. Mjetet
  - 2.10. Puna paraprake para fillimit të punimeve (Organizimi i kantierit)
3. Programi i punimeve
  - 3.1. Planin për Sigurimin e Cilësisë
  - 3.2. Planet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurise
  - 3.3. Procedurat e Emergjencës
  - 3.4. Plani i Menaxhimit të Trafikut
4. Metodologjia e punimeve
  - 4.1. Mirembajtja rutine
  - 4.2. Punimet e Rehabilitimit
    - 4.2.1. Punimet me dherat, germimi dhe mbushja
    - 4.2.2. Punimet per nenshtresen granulare
    - 4.2.3. Punimet per shtresat asfaltike (binder&tapet)
    - 4.2.4. Punimet e betonit dhe betonit te armuar
    - 4.2.5. Punimet per veprat e artit

- 4.2.6. Punimet per sinjalistiken dhe sigurine rrugore
- 4.3. Punimet e Mirembajtjes Dimerore
  - 4.3.1. Hyrje
  - 4.3.2. Situatat ne rruge gjate dimrit
  - 4.3.3. Sherbimet qe do ofrohen
  - 4.3.4. Materialet kunder ngrices
  - 4.3.5. Pajisjet
  - 4.3.6. Sherbimet e mirembajtjes dimerore
- 4.4. Punimet Emergjente

## METODOLOGJIA

Page 3 of 65

- 5. Siguria ne Rruge dhe Kontrolli i trafikut
    - 5.1. Te pergjithshme
    - 5.2. Masat per kontrollin e trafikut
    - 5.3. Numri i korsive te trafikut
    - 5.4. Rruget e perkoheshme
  - 6. Menaxhimi Ambiental
    - 6.1. Te pergjithshme
    - 6.2. Zevendesimi i bimesise
    - 6.3. Nivelet e zhurmave
    - 6.4. Rruget e aksesit
    - 6.5. Rruget hyrese ne pronen private
    - 6.6. Prerja e pemeve
    - 6.7. Informimi i publikut
- Aneks: Skema e sinjalistikes

III.3.7. Në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “VASHTEMI” SHPK është paraqitur një metodologji e përgjithshme në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës, si dhe garancia e punimeve e ofertuar prej tij është 2 (dy) vjet e 5 (pesë) muaj. Ndërkohë në metodologjinë e punimeve për mirëmbajtjen e rrugëve të propozuar nga ana e ofertuesit “VASHTEMI” SHPK një prej komponentëve kryesorë të cilësisë së punimeve që është garancia e punimeve nga ana e këtij operatori ekonomik është ofertuar për një periudhë 2 (dy) vjet.

Me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik “REJ” SHPK ka propozuar metodologjinë e tij lidhur me *cilësinë e punimeve, duke propozuar një periudhë garancie të punimeve më të madhe se shoqëria “VASHTEMI” SHPK ndaj si rrjedhojë pretendimi i tij për një rivlerësim sa më afër kufirit maksimal lidhur me kriterin e vlerësimit të cilësisë së punimeve është i bazuar.*

*Gjithashtu me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik “REJ” SHPK ka propozuar metodologjinë e tij lidhur me propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, ku ndërkohë që komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka përcaktuar metodologjinë që ka ndjekur*

*për vlerësimin me pikë të këtij kriteri, si rrjedhojë pretendimi i tij për një rivlerësim sa më afër kufirit maksimal lidhur me kriterin e vlerësimit të propozimit për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social është i bazuar.*

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit në procedurat e kufizuara duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteret e vlerësimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor për cilësinë e punimeve dhe për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social është plotësuar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Vlerësimi i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastin konkret nuk është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK dhe metodologjinë e ndjekur nga komisioni i vlerësimit të ofertave për përcaktimin e pikëve për kriteret e vlerësimit, pasi garancia e punimeve të propozuar prej tij është për një afat kohor më të madh se ofertuesi tjetër, ndërsa lidhur me pretendimin për rivlerësimin sa më afër pikëve maksimale lidhur propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social pretendimi i ankimesit qëndron, pasi referuar procesit të vlerësimit të ndjekur nga komisioni i vlerësimit të ofertave nuk është përcaktuar metodologjinë që ka ndjekur për vlerësimin me pikë të këtij kriteri. Përsa me sipër, autoriteti kontraktor duhet që të rivlerësojë pikët për ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “REJ” SHPK dhe “VASHTEMLIA” SHPK lidhur me kriteret e vlerësimit të cilësisë së punimeve, si dhe për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar prej tyre, si dhe metodologjisë së zgjedhur për vlerësimin me pikë të ofertave.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “REJ” shpk qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimesi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-21749-03-10-2022, me objekt “Loti 7 Mirembajtje me performance e segmentit rrugor K/Podgorie - K/Liqena”



me fond limit: 59.075.701 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*REJ*” SHPK.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**